



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 2351/12 prot.

Datë 26/09/2024

**V E N D I M**  
**Nr. 1342/2024**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26/09/2024, mori në shqyrtim çështjen me,

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 1249/2024, datë 16.09.2024 për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar” me objekt: Blerje materiale kancelarie e ndarë në 3 lote, Marrëveshje kuadër. **Loti II** me Nr. REF-09066-06-11-2024, me objekt: “Materiale Kancelarie të tjera zyre”, me fond limit 5,737,948 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 29.07.2024, nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara SH.A.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK, me nipt: J62426002Q.  
*Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, Km 8, Kashar, Tiranë.*
- Subjekte të Interesuara:** Operatori ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” SHPK, me NIPT: L91418502J  
*Adresa: Zona Kadastrale nr.8517, e llojit truall plus ndërtesë 4 kate, Durrës.*
- Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Blerjeve të Përqendruara Sh.A  
*Adresa: Rr. “Reshit Çollaku” Nr.6/337, Tiranë.*
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për

*Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

**Vëren:**

**I**

*Rrethanat e çështjes*

I.1. Në datë 16.09.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 1249/2024, ku vendosi:

[...]

1. *Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK lidhur me procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me objekt: Blerje materiale kancelarie e ndarë në 3 lote, Marrëveshje kuadër. **Loti II** me Nr. REF-09066-06-11-2024, me objekt: “Materiale Kancelarie të tjera zyre”, me fond limit 5,737,948 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 29.07.2024, nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara SH.A.*
2. *Autoriteti Kontraktor të rivlerësojë ofertat, duke skualifikuar operatorin ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” SHPK, sipas Vendimit të autoritetit kontraktor dhe konstatimeve të këtij vendimi.*
3. *Autoriteti Kontraktor brenda 5 ditëve, të njoftojë KPP mbi veprimet e ndërmarra në përputhje me konstatimet e këtij vendimi.*
4. *Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK.*
5. *Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.*

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë. [...]*”

I.2. Me shkresën nr. 499/44 prot., datë 25.09.2024, protokolluar me tonën nr. 2351/9 prot., datë 26.09.2024, autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara Sh.A informon se ka zbatuar vendimin Nr. 1249/2024, datë 16.09.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar” me objekt: Blerje materiale kancelarie e ndarë në 3 lote, Marrëveshje kuadër. **Loti II** me Nr. REF-09066-06-11-2024, me objekt: “Materiale Kancelarie të tjera zyre”, me fond limit 5,737,948 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 29.07.2024, nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara SH.A.

**Komisioni i Prokurimit Publik**

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

**Arsyeton**

II.1. Me shkresën nr. 499/44 prot., datë 25.09.2024, protokolluar me tonën nr. 2351/9 prot., datë 26.09.2024, autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara Sh.A informon se ka zbatuar vendimin Nr. 1249/2024, datë 16.09.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*” me objekt: Blerje materiale kancelarie e ndarë në 3 lote, Marrëveshje kuadër. **Loti II** me Nr. REF-09066-06-11-2024, me objekt: “Materiale Kancelarie të tjera zyre”, me fond limit 5,737,948 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 29.07.2024, nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara SH.A.

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe verifikimeve të kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, konstatohet se, autoriteti kontraktor ka kryer rivlersimin e procedurës së prokurimit dhe ka skualifikuar operatorin ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” SHPK, në përputhje me vendimin Nr. 1249/2024, datë 16.09.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik.

II.2. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara SH.A ka zbatuar vendimin Nr. 1249/2024, datë 16.09.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

## Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*” me objekt: Blerje materiale kancelarie e ndarë në 3 lote, Marrëveshje kuadër. **Loti II** me Nr. REF-09066-06-11-2024, me objekt: “Materiale Kancelarie të tjera zyre”, me fond limit 5,737,948 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 29.07.2024, nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara SH.A.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar  
Kreshnik Ternova

Anëtar  
Gjergj Mersini

Kryetar  
Jonaid Myzyri

